




REPUBLIKA E KOSOVËS - PUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT ANTICORRUPTION AGENCY	
Dep. Dop. Dop.	DPK
Nr. Ttad Dre. si rruga Nr. shtet	02
Nr. Prot B. Prot Prot. No	03-02/4163/17
Data Datim Dm	18.12.2017



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 13.12.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-3511/17, për z. Ismail Bytyqi, ish Anëtar i Bordit në Ndërmarrjen Publike Lokale Stacioni i Autobusëve në Suharekë, për shkak se i njëjti tashmë nuk gjendet në mesin e zyrtarëve të lartë publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për Konflikt Interesi në Ushtimin e Funkcionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Ismail Bytyqi, ish Anëtar i Bordit në Ndërmarrjen Publike Lokale Stacioni i Autobusëve në Suharekë, për shkak se ai është dyshuar se ushtron edhe një funksion menaxhues në një biznes privat.

Prandaj, zyrtari i lartë është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj shkrese kemi organizuar një takim me zyrtarin e lartë. Gjatë këtij takimi z. Bytyqi e ka njoftuar Agjencinë se tashmë nuk e ushtron funksionin Anëtar i Bordit në Ndërmarrjen Publike Lokale Stacioni i Autobusëve në Suharekë.

Ndërkohë, zyrtari i lartë ka sjellë në Agjenci një shkresë zyrtare (03/3689/17) me të cilën dëshmohet se z. Bytyqi nuk e ushtron funksionin Anëtar i Bordit në Ndërmarrjen Publike Lokale

Stacioni i Autobusëve në Suharekë dhe tashmë ai nuk gjendet në mesin e zyrtarëve të lartë publik. Prandaj pushojnë hetimet për konflikt interesi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

